



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Ekstra 43

Qershor

2010

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Akt normativ nr.2, datë 10.11.2005	Për lejimin e KESH sh.a., të marrë pjesë në ankandet e blerjes së kapaciteteve transmetuese dhe të energjisë elektrike.....	3
Akt normativ nr.3, datë 23.11.2005	Për një shtesë në ligjin nr.7971, datë 26.7.1995 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar.....	3
Akt normativ nr.5, datë 28.12.2005	Për dërgimin e personelit ushtarak shqiptar, në përbërje të shtabit të SEEBRIG-ut, në Misionin e Mbështetjes së Paqes (ISAF), në Afganistan, të drejtuar nga NATO.....	4
Vendim i KM nr. 11, datë 7.1.2005	Për dhënie fondi buxhetor Kryqit të Kuq Shqiptar si ndihmë financiare për vendet e Azisë Juglindore, të cilat janë prekur nga tsunami, si dhe për forcimin e kapaciteteve të veta, për përballimin e situatave të emergjencave civile apo fatkeqësive natyrore.....	4
Vendim i KM nr.19, datë 7.1.2005	Për lirim dhe emërim në detyrë të prefektit të qarkut të Tiranës.....	5
Vendim i KM nr.28, datë 13.1.2005	Për miratimin e “Planit të pestë të masave për sektorin e energjisë elektrike, për vitet 2005-2007”.....	5
Vendim i KM nr.40, datë 13.1.2005	Për lejimin e KESH sh.a., të bëjë rivlerësimin e pasurisë.....	6
Vendim i KM nr.57, datë 28.1.2005	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2005, miratuar për Ministrinë e Shëndetësisë, për mbulimin e shpenzimeve të bëra për kurimin jashtë shtetit të Drejtorit të Shërbimit Informativ Shtetëror, zotit Kujtim Hysenaj.....	6

Vendim i KM nr.78, datë 4.2.2005	Për shkarkim nga detyra.....	7
Vendim i KM nr.94, datë 11.2.2005	Për lirim dhe emërim në detyrë.....	7
Vendim i KM nr.118, datë 25.2.2005	Për pajisjen me mjedise për seli të partisë “Demokracia Sociale”.....	7
Vendim i KM nr.126, datë 9.3.2005	Për dhënie shtesë pensioni të posaçëm shtetëro,r zotit Gëzim Kruja.....	9
Vendim i KM nr.127, datë 9.3.2005	Për dhënie shtesë pensioni të posaçëm shtetëror, zotit Aleko Kruta.....	9
Vendim i KM nr.128, datë 9.3.2005	Për dhënie shtesë pensioni të posaçëm shtetëror, zonjës Anida Prodani (Take).....	9
Vendim i KM nr.129, datë 9.3.2005	Për dhënie shtesë pensioni të posaçëm shtetëror, zotit Niko Nikolla.....	10
Vendim i KM nr.130, datë 9.3.2005	Për dhënie shtesë pensioni të posaçëm shtetëror, zotit Et’hem Berhani.....	10
Vendim i KM nr.137, datë 18.3.2005	Për miratimin e planit të veprimeve për parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit, 2005.....	11
Vendim i KM nr.152, datë 18.3.2005	Për lirim nga detyra.....	11
Vendim i KM nr.154, datë 9.3.2005	Për miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Sllovakisë, për bashkëpunimin dhe asistencën e ndërsjellë në çështjet doganore.....	12
Vendim i KM nr.166, datë 25.3.2005	Për dhënie shtesë pensioni të posaçëm shtetëror, zotit Ndoc Doda (Gjetja).....	20
Vendim i KM nr.172, datë 25.2.2005	Për ristrukturimin e kompanisë komando, të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, së bashku me strukturat mbështetëse, të dërguara në rajonin e Gjirit Persik, në kuadër të koalicionit ndërkombëtar të luftës kundër terrorizmit.....	20
Vendim i KM nr.175, datë 25.3.2005	Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura të ujësjellësve ndaj KESH sh.a. dhe të tretëve, për tremujorin e parë të vitit 2005.....	21
Vendim i KM nr.184, datë 31.3.2005	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2005, miratuar për Ministrinë e Shëndetësisë, për mbulimin e shpenzimeve të kurimit të dr.Adrian Osmanliu jashtë shtetit.....	21

Vendim i KM nr.187, datë 31.3.2005	Për emërim në detyrë.....	22
Vendim i KM nr.205, datë 7.4.2005	Për emërim dhe lirim nga detyra të anëtarit të komisionit kombëtar rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura.....	22
Vendim i KM nr.219, datë 15.4.2005	Për miratimin e liritimit nga detyra të inspektorit të përgjithshëm të Inspektoratit Shtetëror të Punës, z.Blendi Marika, dhe emërimit në këtë detyrë të z. Sokol Kraja.....	23
Vendim i KM nr.242, datë 21.4.2005	Për miratimin e dokumentit të politikave të zhvillimit, për programin e menaxhimit të integruar dhe të pastrimit të zonës bregdetare	23
Vendim i KM nr.295, datë 6.5.2005	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2005, miratuar për Ministrinë e Shëndetësisë, për mbulimin e pjesëshëm të shpenzimeve të kurimit të znj.Xhemile Kuka, në Turqi.....	28
Vendim i KM nr.347, datë 20.5.2005	Për lirim dhe emërim në detyrë të prefektit të qarkut Shkodër.....	28
Vendim i KM nr.349, datë 20.5.2005	Për lirim dhe emërim në detyrë të prefektit të qarkut Elbasan.....	29
Vendim i KM nr.350, datë 20.5.2005	Për lirim dhe emërim në detyrë të prefektit të qarkut Fier.....	29
Vendim i KM nr.360, datë 26.5.2005	Për lirim dhe emërim në detyrë të prefektit të qarkut të Gjirokastrës.....	29
Vendim i KM nr.361, datë 26.5.2005	Për lirim dhe emërim në detyrë të prefektit të qarkut të Lezhës.....	30
Vendim i KM nr.366, datë 30.5.2005	Për lirim dhe emërim në detyrë	30
Vendim i KM nr.367, datë 30.5.2005	Për lirim nga detyra	31
Vendim i KM nr.416, datë 9.6.2005	Për dhënie municioni Forcave të Armatosura të Republikës së Turqisë, në kuadër të bashkëpunimit dypalësh në fushën e mbrojtjes.....	31
Vendim i KM nr.436, datë 16.6.2005	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2005, miratuar për Ministrinë e Shëndetësisë, për mbulimin e pjesëshëm të shpenzimeve të kurimit të z.Gentian Shkoza jashtë shtetit.....	31
Vendim i KM nr.438, datë 16.6.2005	Për transferimin në pronësi të komunës Labinot-Fushë të mjediseve të pronës “Grup depo të repartit ushtarak nr.8833”, në Mengel, Elbasan, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes, dhe për një ndryshim në vendimin nr.515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë më përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes”	32

AKT NORMATIV
Nr.2, datë 10.11.2005

**PËR LEJIMIN E KESH, SHA-SË, TË MARRË PJESE NË ANKANDET E BLERJES SË
KAPACITETEVE TRANSMETUESE DHE TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Neni 1

Lejimin e KESH, sha-së të marrë pjesë në ankandet e blerjes së kapaciteteve transmetuese, për transmetimin e energjisë elektrike, sipas kërkesave dhe procedurave të kërkuara nga shoqëritë, që organizojnë këto ankande apo shesin kapacitete transmetuese.

Neni 2

Lejimin e KESH sha-së, të marrë pjesë në ankandet për blerjen e energjisë elektrike, sipas kërkesave dhe procedurave të kërkuara nga shoqëritë, që organizojnë këto ankande apo shesin energjinë elektrike, për sasinë deri në 600 milionë kwh në vit.

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

AKT NORMATIV
Nr.3, datë 23.11.2005

**PËR NJË SHITESË NË LIGJIN NR.7971, DATË 26.7.1995 “PËR PROKURIMIN PUBLIK”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në ligjin nr.7971, datë 26.7.1995 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, të bëhet kjo shtesë:

Neni 1

Pas paragrafit 3, të shtohet paragrafi 3/1 me këtë përmbajtje:

“Për mallin energji elektrike, oferta do të jetë e vlefshme edhe nëse ajo vjen mbi fondin limit të shpallur në ftesën për ofertë, si dhe për sasi më të vogla.”.

Neni 2

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

AKT NORMATIV
Nr.5, datë 28.12.2005

PËR DËRGIMIN E PERSONELIT USHTARAK SHQIPTAR, NË PËRBËRJE TË SHTABIT TË SEEBRIG-UT, NË MISIONIN E MBËSHETJES SË PAQES (ISAF), NË AFGANISTAN, TË DREJTUAR NGA NATO

Në mbështetje të neneve 12, pika 3 dhe 101 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Neni 1

Dërgimin e personelit shqiptar, prej 9 ushtarakësh, në përbërje të shtabit të SEEBRIG-ut, në Misionin e Mbështetjes së Paqes (ISAF), në Afganistan, të drejtuar nga NATO.

Neni 2

Ministria e Mbrojtjes të përballojë efektet financiare për kontributin e Republikës së Shqipërisë në dislokimin, përdorimin dhe ridislokimin e shtabit të SEEBRIG-ut, në Misionin e Mbështetjes së Paqes, ISAF, nga Konstanca e Rumanisë në Kabul të Afganistanit.

Neni 3

Ushtarakët shqiptarë, në përbërje të shtabit të SEEBRIG-ut, për ditët e qëndrimit në mision, në Afganistan, përveç pagës mujore, të marrin, për vështirësi shërbimi, dhe një shpërblim ditor, në masën, që do të caktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 4

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 11, datë 7.1.2005

PËR DHËNIE FONDI BUXHETOR KRYQIT TË KUQ SHQIPTAR SI NDIHMË FINANCIARE PËR VENDET E AZISË JUGLINDORE, TË CILA JANË PREKUR NGA TSUNAMI, SI DHE PËR FORCIMIN E KAPACITETEVE TË VETA, PËR PËRBALLIMIN E SITUATAVE TË EMERGJENCAVE CIVILE APO FATKEQËSIVE NATYRORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 7 të ligjit nr.7864, datë 29.9.1994 “Për Kryqin e Kuq Shqiptar”, të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë”, dhe të neneve 7 e 10 të ligjit nr.9339, datë 21.12.2004 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2005”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kryqit të Kuq Shqiptar, nëpërmjet Ministrisë së Shëndetësisë, t'i jepet fondi prej 500 000 (pesëqind mijë) dollarësh amerikanë, kontribut i qeverisë shqiptare, si ndihmë humanitare për përballimin e pasojave të shkaktuara nga tsunami, që goditi brigjet e vendeve të Azisë Juglindore, si dhe për forcimin e kapaciteteve të veta, për përballimin e situatave të emergjencave civile apo fatkeqësive natyrore.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

3. Ngarkohen Ministri i Shëndetësisë dhe Ministri i Financave për zbatimin e këtij vendimi
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM

Nr.19, datë 7.1.2005

PËR LIRIM DHE EMËRIM NË DETYRË TË PREFEKTIT TË QARKUT TË TIRANËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4 të ligjit nr.8927, datë 25.7.2002 “Për prefektin”, me propozimin e Ministrisë të Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Zoti Besnik Dervishi, prefekt i qarkut të Tiranës, lirohet nga kjo detyrë.

Zonja Mimi Kodheli emërohet prefekt i qarkut të Tiranës.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM

Nr.28, datë 13.1.2005

PËR MIRATIMIN E “PLANIT TË PESTË TË MASAVE PËR SEKTORIN E ENERGJISË ELEKTRIKE, PËR VITET 2005-2007”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrisë të Industrisë dhe të Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e “Planit të pestë të masave për sektorin e energjisë elektrike, për vitet 2005-2007”.

2. Vendimi nr. 858, datë 24.12.2003 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e “Planit të katërt të masave për sektorin e energjisë elektrike, për vitet 2004-2006””, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.40, datë 13.1.2005

PËR LEJIMIN E KESH-SHA-SË, TË BËJË RIVLERËSIMIN E PASURISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “c” të nenit 70 të ligjit nr.7661, datë 19.1.1993 “Për kontabilitetin”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë dhe të Ministrit të Industrisë dhe të Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. KESH, sh.a.-ja të kryejë rivlerësimin e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara, në zotërim të shoqërisë, duke përdorur metodat e IFRS-së (Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar).
 2. Efektet, që dalin nga zbatimi i këtij vendimi, të pasqyrohen në vitin financiar 2005, në mbështetje të ligjit nr.7661, datë 19.1.1993 “Për kontabilitetin” dhe të vendimit nr.334, datë 9.7.1993 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Planit Kontabël të Përgjithshëm”.
 3. Efektet e këtij rivlerësimi të njihen nga sistemi fiskal.
 4. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Ministria e Industrisë dhe e Energjetikës dhe KESH-sh.a.-ja, për zbatimin e këtij vendim.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.57, datë 28.1.2005

PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2005, MIRATUAR PËR MINISTRINË E SHËNDETËSISË, PËR MBULIMIN E SHPENZIMEVE TË BËRA PËR KURIMIN JASHTË SHTETIT TË DREJTORIT TË SHËRBIMIT INFORMATIV SHTETËROR, ZOTIT KUJTIM HYSENAJ

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë”, dhe të neneve 7 e 10 të ligjit nr.9339, datë 21.12.2004 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2005”, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Shëndetësisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2005, zëri “Shpenzime operative”, t’i shtohet fondi prej 2 100 000 (dy milionë e njëqind mijë) lekësh, për mbulimin e shpenzimeve të bëra për kurimin jashtë shtetit të drejtorit të Shërbimit Informativ Shtetëror, z.Kujtim Hysenaj.
 2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.
 3. Pagesa të kryhet pas paraqitjes së faturave përkatëse.
 4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr. 78, datë 4.2.2005

PËR SHKARKIM NGA DETYRA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 94 të ligjit nr.7819, datë 27.4.1994 “Për pronësinë industriale”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Z. Spartak Bozo, drejtor i Drejtorisë së Patentave, shkarkohet nga kjo detyrë.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.94, datë 11.2.2005

PËR LIRIM DHE EMËRIM NË DETYRË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4 e 5 të ligjit nr.8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, me propozimin e Ministrit të Shtetit për Koordinimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Zonja Mirlinda Nuro lirohet nga detyra e anëtarit të Komisionit Kombëtar Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura,
 2. Zonja Lida Zeqo emërohet anëtar i Komisionit Kombëtar Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura, për periudhën e mbetur deri në mbarim të mandatit të anëtarit që lirohet.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.118, datë 25.2.2005


PËR PAJISJEN ME MJEDISE PËR SELI TË PARTISË “DEMOKRACIA SOCIALE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “b” të nenit 22 të ligjit nr.8580, datë 17.2.2000 “Për partitë politike”, me propozimin e Ministrit të Shtetit për Koordinimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Partisë “Demokracia Sociale” t’i jepen në përdorim mjediset e katit të tretë, me sipërfaqe 140 m², të klinikës stomatologjike në bulevardin “Zogu I”, sipas planimetrisë që i bashkëlidhet këtij vendimi, si mjedise për seli.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano



ZYRAT E SELISE QENDRORE
 TE PARTISE DEMOKRACIA SOCIALE
 SIP. 140 M2

PLANIMETRIA SH. 1:100

VENDIM
Nr.126, datë 9.3.2005

PËR DHËNIE SHITESË PENSIONI TË POSAÇËM SHTETËROR ZOTIT GËZIM KRUJA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Dhënie shtesë pensioni të posaçëm shtetëror zotit Gëzim Kruja, në masën e pensionit maksimal, por shuma e pensionit, që i takon sipas ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, plus këtë shtesë, të mos kalojë dyfishin e pensionit maksimal.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.127, datë 9.3.2005

PËR DHËNIE SHITESË PENSIONI TË POSAÇËM SHTETËROR ZOTIT ALEKO KRUTA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Dhënie shtesë pensioni të posaçëm shtetëror zotit Aleko Kruta, në masën e pensionit maksimal, por shuma e pensionit, që i takon sipas ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, plus këtë shtesë, të mos kalojë dyfishin e pensionit maksimal.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.128, datë 9.3.2005

**PËR DHËNIE SHITESË PENSIONI TË POSAÇËM SHTETËROR ZONJËS ANIDA
PRODANI (TAKE)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Dhënie shtesë pensioni të posaçëm shtetëror zonjës Anida Prodani (Take), në masën e pensionit maksimal, por shuma e pensionit, që i takon sipas ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, plus këtë shtesë, të mos kalojë dyfishin e pensionit maksimal.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.129, datë 9.3.2005

PËR DHËNIE SHITESË PENSIONI TË POSAÇËM SHTETËROR ZOTIT NIKO NIKOLLA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Dhënie shtesë pensioni të posaçëm shtetëror zotit Niko Nikolla, në masën e pensionit maksimal, por shuma e pensionit, që i takon sipas ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, plus këtë shtesë, të mos kalojë dyfishin e pensionit maksimal.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.130, datë 9.3.2005

**PËR DHËNIE SHITESË PENSIONI TË POSAÇËM SHTETËROR ZOTIT ET’HEM
BERHANI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Dhënie shtesë pensioni të posaçëm shtetëror zotit Et’hem Berhani, në masën e pensionit maksimal, por shuma e pensionit, që i takon sipas ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, plus këtë shtesë, të mos kalojë dyfishin e pensionit maksimal.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.137, datë 18.3.2005

**PËR MIRATIMIN E PLANIT TË VEPRIMEVE PËR PARANDALIMIN DHE LUFTËN
KUNDËR KORRUPSIONIT, 2005**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Shtetit për Koordinimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e planit të veprimeve për parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit, 2005, i cili i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ministrinë dhe institucionet qendrore të bashkërendojnë punën me institucionet e pavarura dhe organizmat e shoqërisë civile, të përmendura në planin e veprimeve, për zbatimin e masave të përcaktuara në këtë plan.

3. Ministri i Shtetit për Koordinimin dhe grupi i monitorimit antikorrupsion të ndjekin dhe të raportojnë në Këshillin e Ministrave për zbatimin e planit të veprimeve.

4. Ngarkohen ministrinë dhe institucionet shtetërore, të përmendura në këtë plan, që çdo gjashtë muaj dhe sa herë që u kërkohet, t'i raportojnë Ministrinë të Shtetit për Koordinimin për realizimet respektive, të masave të parashikuara në planin e veprimeve dhe për treguesit statistikorë të rezultateve të arritura.

5. Ngarkohen ministrinë dhe institucionet qendrore për zbatimin e këtij plani veprimesh.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.152, datë 18.3.2005

PËR LIRIM NGA DETYRA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 6 të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003 "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Z. Ilir Ciko, zëvendësministër i Ekonomisë, lirohet nga kjo detyrë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.154, datë 9.3.2005

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SLOVAKISË,
PËR BASHKËPUNIMIN DHE ASISTENCËN E NDËRSJELLË NË ÇËSHTJET DOGANORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Sllovakisë, për bashkëpunimin dhe asistencën e ndërsjellë në çështjet doganore.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

MARREVESHJE

**NDERMJET KESHILLIT TE MINISTRAVE TE REPUBLIKES SE SHQIPERISE DHE
QEVERISE SE REPUBLIKES SE SLOVAKISE .MBI BASHKEPUNIMIN DHE ASISTENCE
TE NDERSJLLTE NE ÇESHTJET DOGANORE**

Keshilli i Ministrave te Republikes se Shqiperise dhe Qeveria e Republikes se Sllovakisë, ketej e tutje referuar si “Pale Kontraktuese”;

DUKE KONSIDERUAR rendësin e sigurimit te përllogaritjes dhe grumbullimit te sakte te detyrimeve doganore dhe taksave te tjera mbi importet ose eksportet e mallrave, si dhe zbatimin e sakte te dispozitave mbi kufizimet, ndalimet dhe kontrollin;

DUKE KONSIDERUAR se shkeljet ndaj Legjislacionit Doganor janë te dëmshme per interesat ekonomike, fiskale, tregtare dhe sociale te vendeve te tyre respektive, si dhe te interesit te tregtisë se ligjshme;

DUKE NJOHUR nevojën për aksione te kombinuara ne luftën kundër trafikut ilegal te lendeve narkotike dhe substancave psikotrope;

TE BINDUR se aksionet për te parandaluar shkeljet kundër legjislacionit doganor dhe përpjekjet te siguruar grumbullimin e sakte te detyrimeve te importit dhe eksportit, taksave dhe detyrimeve te tjera mund te arrihen me efektivisht nëpërmjet koperimit te ngushte ndërmjet

Autoriteteve te tyre Doganore;

DUKE marre ne konsiderate maredheniet ekzistuese miqësore nderrnjete Republikes se Sllovakisë dhe Republikës se Shqipërisë;

DUKE marre ne konsiderate rekomandimet e Këshillit te Kooperimit Doganor mbi Asistencën Reciproke Administrative, te 5 dhjetorit 1953;

DUKE marre ne konsiderate gjithashtu dispozitat & Konventes mbi Drogat Narkotike te 1961, te amenduar me Protokollin e 1972 dhe Konventen mbi Substancat Psikotrope te 1971 te përgatitur nen autorizimin e Organizatës se Kombeve te Bashkuara, si dhe te Konventes se Kombeve te Bashkuara kundër Trafikut Ilegal te Lendeve Narkotike dhe Substancave Psikotrope te 1988; rane dakord sa me poshtë vijon:

Neni 1
Perkufizime

Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje:

a) “Autoritet Doganor” do të thotë, në Republikën e Shqipërisë - Drejtoria e Përgjithshme e Doganave e Ministrisë së Financave; dhe në Republikën e Sllovakisë - Drejtoria e Doganave e Republikës së Sllovakisë;

b) “Legjislacion doganor” do të thotë dispozitat e përcaktuara nga ligje apo rregullore të dyja Palëve Kontraktuese lidhur me importimin, eksportimin, tranzitimin e mallrave apo çfarëdo procedure tjetër doganore, si e lidhur me detyrimet doganore, taksat apo kuotat e tjera të ushtruara nga Autoriteti Doganor ashtu edhe me masat e ndalimit, kufizimit apo kontrollit të ushtruara nga Autoriteti Doganor;

c) “Shkelje” (kundervajtje) do të thotë çdo shkelje e Legjislacionit Doganor si dhe çdo përpjekje për shkelje të këtij legjislacioni;

d) “Autoriteti doganor kërkues” do të thotë autoriteti doganor kompetent i një Pale Kontraktuese i cili bën një kërkesë për asistencë në çështjet doganore;

e) “Autoriteti doganor i kërkuar” do të thotë autoriteti doganor kompetent i një Pale Kontraktuese i cili merr një kërkesë për asistencë në çështjet doganore;

f) “Person” do të thotë një person fizik dhe/ose një person juridik;

g) “Informacion” do të thotë kryesisht raporte, regjistra, dokumente, dokumentacion, tekompjuterizuar ose si dhe kopje të noterizuara të këtyre;

h) “Te dhëna personale” do të thotë çdo lloj e dhëne lidhur me persona fizike të identifikuar apo të identifikueshëm;

i) “Shpendarie nën Kontroll” do të thotë teknika e kërkimit të ngarkesës së paligjshme apo të dyshuar të drogave narkotike, substancave psikotrope dhe prekursiveve. dhe specieve të rrezikuara të flores dhe faunes, ose substancave të zëvendësuar për to, që të kalojnë jashtë, brenda ose nepermjet territorit të Shteteve të Paleve Kontraktuese me njohurinë dhe nën vëzhgimin e autoriteteve të tyre kompetente, me qëllim identifikimin e personave të përfshirë në trafikun e paligjshëm të drogave narkotike, substancave psikotropë dhe prekursiveve dhe specieve të rrezikuara të flores dhe faunes së eger.

Neni 2
Qëllimi i Marrëveshjes

1. Palët Kontraktuese, nëpërmjet Autoriteteve Doganore dhe në përputhje me dispozitat e caktuara në këtë Marrëveshjet, do t'i mundësojnë njëra-tjetres asistencë të ndërsjelle:

a) me synim sigurimin se legjislacioni doganor është zbatuar saktësisht;

b) me synim të sigurojnë përcaktimin e sakte të detyrimeve doganore, taksave dhe kuotave të tjera;

c) në ndërmarrjen e masave me synim lehtësimin dhe kontrollin e lëvizjes së pasagjereve dhe rrjedhjes së mallrave;

d) me synim parandalimin, hetimin dhe luftën kundër shkeljeve të legjislacionit doganor;

e) në rastet lidhur me dërgimin e dokumenteve lidhur me aplikimin e legjislacionit doganor;

f) në shkëmbimin e eksperiencës teknike me synim promovimin e punës së Autoriteteve Doganore respektive.

2. Asistenca në kuadrin e Marrëveshjes në fjalë do të jepet në përputhje me legjislacionin në fuqi në territorin e shtetit të Palës Kontraktuese të kërkuar dhe brenda kompetencave dhe resorëve të autoritetit doganor të kërkuar. Nëse është e nevojshme, një autoritet doganor mund të rregullojë asistencë të mundësohet nga një autoritet tjetër kompetent në përputhje me legjislacionin në territorin e Shtetit të Paleve Kontraktuese të kërkuar. rimi i kësaj Marrëveshjeje nuk do të ndikojë mbi detyrimet e paleve kontraktuese sipas konventave ndërkombëtare apo Marrëveshjeve në fushat juridike.

Neni 3

Survejimi i personave, mallrave, mjeteve te transportit dhe vendeve

Autoriteti doganor i një Pale kontraktuese, brenda kompetencave dhe mundësive te veta, me iniciativën e vet ose sipas kërkesës se autoritet doganor te Palës tjetër kontraktuese, do te kryeje mbi lëvizjen veçanërisht për hyrjen ne, dhe daljen nga territori i Shtetit te vet te personave te njohur si dyshuar se mund te kryejnë ose kane kryer shkelje te Legjislacionit doganor ne fuqi ne territorin e shtetit te Palës tjetër kontraktuese;

Lëvizjen e mallrave, te raportuar nga autoriteti doganor i Palës tjetër kontraktues që mund të shkaktojë dyshime për kryerjen e trafikut te paligjshëm për ne, ose nga territori i Shtetit te vet; ndaj çdo mjeti transporti ose kontejnerë te njohur ose te dyshuar se janë përdorur për kryerjen e lëvizjeve kundër legjislacionit doganor;

Vende të përdorura për magazinim ilegal te mallrave ne territorin e shtetit te Palës respektive kontraktuese.

Neni 4

Aksionet kunder trafikut te paligjshem te mallrave te caktuara

autoritetet doganore, me iniciativën e vet ose sipas kërkesës, bazuar ne konsultime dhe ne koordinim me autoritete te tjera kompetente, pa vonesa, do t'i mundësojnë njëra-tjetrës gjithë informacionin përkatës mbi veprimtari te cilat përbejnë ose mund te përbejnë një shkelje ndaj legjislacionit ne fuqi ne territorin e Shtetit te njërrës prej Palëve Kontraktuese, lidhur me:

- trafikun e drogave narkotike, substancave psikotrope dhe prekursiveve;
- trafikun e armeve, municioneve, eksploziveve;
- lëvizjen e mallrave sensitive dhe strategjike te kushtëzuara nga kontrole speciale ne perputhje me traktatet ndërkombëtare përkatëse dhe marrëveshje shumëpalëshe qe sjellin detyrime mbi shpërndarjen, ne te cilat te dyja palët Kontraktuese janë anëtare;
- d) trafikun e veprave te artit dhe antikuarëve te cilat perbejne vlera te rëndësishme historike, kulturore ose arkeologjike për një nga Palët Kontraktuese;
- e) lëvizjen e mallrave helmuese si dhe te mallrave apo substancave te rrezikshme për mjedisin apo shëndetin publik;
- f) trafikun e mallrave te kushtëzuara nga detyrime te larta doganore, taksa apo kuota.

Neni 5

Dergesa te kontrolluara

1) Ne përputhje me legjislacionin kombëtar, Autoritetet Doganore me konsensus reciprok dhe brenda kompetencave te tyre, mund te përdorin shpërndarjen nen kontroll, me synim identifikimin, e personave te implikuar ne trafikun e paligjshern te drogave narkotike dhe substancave psikotrope specieve te rrezikuara te florës dhë faunës se egër, dhe për te ndërmarre aksione ligjore kunder këtyre personave.

2) Vendimet lidhur me përdorimin e procedurës se dërgesave të kontrolluara do te bëhen rast pas rasti dhe kur është e nevojshme në përputhje me rregullimet ose marrëveshjet te cilat mund te jene arritur lidhur me rastin ne fjale. Ne këto raste, nëse është e nevojshme, dhe me kusht qe kjo gjë te jete konform legjislacionit kombëtar te Palëve Kontraktuese, mund te marren ne konsiderate rregullimet financiare dhe mirëkuptimet e arritura ndërmjet te dyja Palëve Kontraktuese.

3) Ngarkesat e paligjshme për te cila është rene dakord procedura e dergesës se kontrolluar, me konsensusin reciprok te autoriteteve kompetente, mund te interceptohen dhe te lejohen te vazhdojne kalimin paprekur drogat narkotike, substancat psikotrope ose substancat zëvendësuese te tyre, ose ne rast se sigurohen kushtet, ato substanca hiqen ose zevendesohen pjeserisht apo plotesisht.

Komunikimi i informacionit

Neni 6

Autoritetet doganore, me iniciativën e vet ose sipas kërkesës, do t'i mundësojnë njëra-tjetrës gjithë informacionin i cili mund të ndihmojë në arritjen e saktësisë mbi:

a) grumbullin e detyrimeve të importit dhe eksportit, taksat dhe detyrimet e tjera të ushtruara nga autoritetet doganore, dhe në veçanti informacionin i cili mund të ndihmojë në përcaktimin e vlerës së mallrave për qëllime doganore dhe për të vendosur klasifikimin e tyre tarifor;

b) zbatimin e ndalimeve dhe kufizimeve të importit, eksportit dhe tranzitit;

c) aplikimin e rregullave të origjinës të pambuluara nga marrëveshjet preferenciale të arritura nga njëra ose të dyja Palët kontraktuese.

Neni 7

Autoritetet doganore, me iniciativën e vet ose sipas kërkesës, do t'i mundësojnë njëra-tjetrës informacionin e mëposhtëm:

a) nëse mallrat e importuara në territorin e shtetit të njërit prej Palëve kontraktuese janë eksportuar ligjërisht nga territori i shtetit të Palës tjetër kontraktuese, dhe natyrën e procedurave doganore, nëse ka, të aplikuara mbi këto mallra;

b) nëse mallrat e eksportuara nga territori i Shtetit të njërit prej Palëve Kontraktuese janë importuar ligjërisht në territorin e Shtetit të Palës tjetër Kontraktuese, dhe natyrën e procedurave doganore nën të cilat janë vendosur këto mallra;

c) nëse mallrat të cilave iu është dhënë trajtim favorizues mbi eksportin nga territori i Shtetit të

• një Pale Kontraktuese janë importuar saktësisht në territorin e Shtetit të Palës tjetër Kontraktuese, me kuptimin që do të mundësohet gjithashtu informacion mbi çdo masë doganore kontrolli të ushtruar mbi këto mallra.

Neni 8

Autoriteti doganor i një Pale kontraktuese, me iniciativën e vet ose sipas kërkesës, do të mundësojë autoritetit doganor të Palës tjetër kontraktuese të gjithë informacionin që mund të jetë i dobishëm ose i lidhur me shkeljet ndaj legjislacionit doganor dhe në veçanti informacionin lidhur me:

a) persona, të njohur ose të dyshuar se janë duke kryer apo kanë kryer shkelje ndaj legjislacionit doganor në fuqi në territorin e shtetit të Palës tjetër kontraktuese;

b) mallra të njohura apo të dyshuara se janë subjekt i shkeljeve doganore;

c) mjetet e transportit apo konteniere të njohura apo të dyshuara se ato, kanë qene përdorur për kryerjen e shkeljeve kundër legjislacionit doganor në fuqi në territorin e shtetit të Palës tjetër kontraktuese;

d) mjete dhe metoda të reja të përdorura në kryerjen e shkeljeve kundër legjislacionit doganor;

e) vende të përdorura për magazinim ilegal të mallrave në territorin e shtetit të Palës tjetër kontraktuese.

Neni 9

1. Nëse autoriteti doganor i kërkuar nuk e ka informacionin e kërkuar, ai mund të kërkojë këtë informacion në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi në territorin e Shtetit të Palës Kontraktuese të Kërkuar.

2. Autoriteti Doganor i Kërkuar, brenda kompetencave të veta, mundësive dhe në përputhje me legjislacionin e vet kombëtar, do të kërkojë informacionin sikur ai të ishte duke vepruar për interes të vet.

Neni 10

1. Autoritetet doganore do ti mundësojnë njëra-tjetrës, sipas kërkesë ose me iniciativën e vet, informacione mbi aktivitete të kryera ose parashikuar për tu kryer të cilat përbejnë ose mund të përbejnë një shkelje.

2. Autoritetet doganore do të kërkojnë origjinalet mbi informacionin, duke përfshirë dosje dhe dokument vetëm në rastet kur kopjet e certifikuara mund të jenë të pamjaftueshme. Sipas kërkesës së njëres prej Autoriteteve Doganore të Palës Kontraktuese, kopje të këtyre dosjeve, dokumenteve dhe materialeve të tjera duhen certifikuar në mënyrën e duhur.

3. Origjinalet e informacionit, duke përfshirë dosjet dhe dokumentet që janë dërguar, duhet të rikthehen me mundësinë më të mirë.

4. Informacioni i mundësuar sipas kësaj Marrëveshjeje mund të transmetohet në rrugë elektronike me çfarëdo mënyre për të njëjtin qëllim. Duhet të përmbajnë në të njëjtën kohë të gjitha shpjegimet e nevojshme për interpretimin dhe përdorimin e këtij informacioni.

Neni 11

Forma dhe përmbajtja e kërkesës për asistencë

1. Kërkesat në zbatim të kësaj Marrëveshjeje do të bëhen me shkrim. Dokumentet e nevojshme për ekzekutimin e një kërkesë të tillë duhet të bashkeshoqerojnë kërkesën. Kur për shkak të emergjencës së situatës mund të bëhet kërkesë gojore, dhe jo kërkesë në mënyrë imediate duhet të konfirmohet nga një kërkesë me shkrim.

2. Kërkesat në përputhje me paragrafin I të këtij Neni do të përfshijnë informacionin e mëposhtëm:

- a) emërtimin e autoritetit doganor që ben kërkesën
- b) masat që kërkohet të ndërmerren;
- c) objekti dhe shkaqet për kërkesë;
- d) ligjet, rregullat dhe aktet e tjerë ligjore, referuar objektit të kërkesës;
- e) treguesit sa më ekzakte dhe të zgjeruar të mundur, mbi personat që janë në qendër të hetimeve,
- f) një përmbledhje të fakteve lidhur me objektin e kërkesës;
- g) lidhjen mes asistencës së kërkuar dhe ceshtjes për të cilën behet fjale.

3. Kërkesa duhet të dërgohet në anglisht ose në një gjuhë tjetër të pranueshme prej autoritetit doganor të kërkuar.

4. Nëse kërkesa nuk i përmbush përcaftimet formale të paragrafit 2 dhe 3 të këtij neni, autoriteti doganor i kërkuar mund të kërkojë korrigjimin ose plotësimin e kërkesës, gjithsesi mund të fillojë marrja e masave paraprake.

Neni 12

Hetime zyrtare

1. Nëse Autoriteti doganor i një Pale kontraktuese e kërkon, autoriteti doganor i Palës tjetër kontraktuese do të nisë hetime zyrtare lidhur me operacionet të cilat janë apo duket se janë në kundërshtim me legjisllacionin në fuqi në territorin e shtetit të Palës kontraktuese kërkuese. Do të komunikohen rezultatet e këtij hetimi autoritetit doganor kërkues.

2. Hetime të tilla do të kryhen sipas legjisllacionit në fuqi në territorin e shtetit të Palës kontraktuese të kërkuar. Autoriteti doganor i kërkuar do të veproje si të ishte duke vepruar për interes të tij.

3. Sipas kërkesës, autoriteti doganor i kërkuar, në rastet e veçanta, me miratimin e autoritetit doganor të Palës tjetër kontraktuese, do të lejojë zyrtaret e autoritetit doganor të Palës kërkuese kontraktuese, të jenë prezent në territorin e shtetit të Palës kontraktuese të kërkuar, duke përfshirë prezencën në hetime zyrtare, kur punonjësit e vet janë duke hetuar shkeje që i interesojnë autoritetit doganor kërkues.

4. Një punonjës i autoritetit doganor të Palës kontraktuese kërkuese prezent në territorin e shtetit të Palës kontraktuese të kërkuar në zbatim të kësaj Marrëveshje, do të veprime vetëm në kapacitet këshilltari dhe nën asnjë kondite nuk do të marrë pjesë aktive në hetim apo të ushtroje ndonjë pushtet ligjor ose hetues dhe punonjësve të autoritetit doganor të kërkuar në përputhje me legjislacionin kombëtar të Palës kontraktuese të kërkuar.

5. Autoriteti doganor kërkues, nëse kërkon, do të këshillohet mbi kohën dhe vendin e aksioneve që do të ndërmerren në përgjigje të kërkesës, në mënyrë që të mund të kryhen aksione të përbashkëta.

6. Punonjësit e autoritetit doganor kërkues të autorizuar për hetimin e shkeljeve mund të kërkojnë që 'autoriteti doganor i kërkuar të ekzaminojë librat përkatës, regjistrat dhe dokumente të tjerë ose të dhëna nga shtypi, dhe të furnizohet me kopje të certifikuara të këtyre, ose të furnizojë me çdo informacion të lidhur me shkeljen .

7. Kur nën kushtet e vendosura nga kjo Marrëveshje, punonjësit e autoritetit doganor të një Pale kontraktuese janë prezent në territorin e shtetit të Palës tjetër kontraktuese ata duhet të jenë të afte në çdo kohë të provojnë kapacitetin e tyre zyrtar. Ata nuk duhet të mbajnë armë dhe as të veshin uniforme .

Perdorimi i informacionit

Neni 13

1. Informacioni dhe komunikimet e tjera të marra nën këtë Marrëveshje nuk do të përdoren për qëllime të tjera nga ato të specifikuara në këtë Marrëveshje, duke përfshirë përdorimin në procedime penale dhe administrative. Ato mund të përdoren për qëllime të tjera vetëm pas aprovimit paraprak me shkrim të autoritetit doganor të kërkuar dhe kushtëzuar nga konditat dhe kufizimet që mund të vendosen.

2. Dispozitat e paragrafit I të këtij neni nuk zbatohen për informacionin që ka të bëjë me shkelje të lidhura me drogën narkotike dhe substancat psikotrope. Ky informacion mund t'u komunikohet autoriteteve të Palës kontraktuese kërkuese të cilat janë direkt të lidhura me luftën kundër trafikut ilegal të drogës. Gjithsesi, ky informacion nuk do të transmetohet palëve të treta pa miratimin paraprak me shkrim të autoritetit doganor të kërkuar.

3. Çdo informacion i dërguar në çfarëdolloj forme në zbatim të kësaj Marrëveshje do të jetë i natyrës konfidenciale. Do të mbulohet nga detyrimi i sekretit zyrtar dhe do të gëzojë mbrojtjen e dhënë një Informacioni të njëjtit lloj dhe dokumenteve, sipas legjislacionit në fuqinë në shtetin e Palës kontraktuese që e merr atë.

4. Pa rënë ndesh me nenin 13 dhe 14, kjo Marrëveshje nuk do të çojë dispozitat e komunitetit të cilat rregullojnë komunikimin midis shërbimeve kompetente të Komisionit të Komunitetit Europian dhe autoriteteve doganore të Republikës Sllovaqe për çdo informacion në interes të komunitetit i cili ka të bëjë me heshtjet doganore.

Neni 14

1. Autoritetet Doganore të Palëve Kontraktuese, në përputhje me qëllimet dhe brenda fushës së veprimit të kësaj Marrëveshje mund të përdorin si fakte në regjistrat e tyre të evidencave, raporteve dhe dëshmi, dhe në proceset e sjella përpara gjykatës, informacionin dhe dokumentet e përfutuara në përputhje me këtë Marrëveshje.

2. Përdorimi i një informacioni të tillë dhe dokumenteve si evidenca në gjyq dhe pesha që do të jepet këtyre do të përcaktohet në përputhje me legjislacionin kombëtar të Palës Kontraktuese.

Neni 15

Mbrojtja e të dhënave personale

Te dhënat personale të shkëmbyera nën këtë Marrëveshje do të përdoren për qëllimet e deklaruara në kërkesën për asistencë dhe kushtëzuar nga konditat që mund të vendosë autoriteti

doganor i kërkuar. Te dhënat personale do te trajtohen ne një natyre konfidenciale dhe do te mbrohen ne përputhje me legjislacionin ne fuqi ne territorin e shtetit te Palës kontraktuese kërkuese.

Neni 16

Dorezimi i dokumentave

Sipas kërkesës, autoriteti doganor i kërkuar, ne përputhje me legjislacionin kombëtar ne fuqi ne territorin e shtetit te Palës kontraktuese te kërkuar, do te njoftoje tek personi fizik apo juridik ne fjale, rezident ose i vendosur ne territorin e vet, te gjitha dokumentet qe bien nen fushën e veprimit te Marrëveshjes dhe qe vijnë nga autoriteti doganor kërkuar.

Neni 17

Ekspertet dhe deshmitaret

1. Sipas kërkeses se autoritetit doganor te një Pale kontraktues, autoriteti doganor i Palës tjetër kontraktuese mund te autorizojë punonjësit e vet, me miratimin e tyre, qe te paraqiten si eksperte apo dëshmitare në gjykimet ose proceset administrative lidhur me shkelje te proceduarave ne territorin e Shtetit te Palës kontraktues kërkuese dhe te përgatisë objekte, akte dhe dokumente te tjera ose kopje te certifikuara te këtyre te fundit për procedime. Këta punonjës duhet te japin evidencat e marra prej tyre gjate kohës se ushtrimit te detyrës.

2. Pala kontraktuese kërkuese është e detyruar te marre gjithë masat e nevojshme për mbrojtjen e sigurisë personale te punonjësve gjate qëndrimit te tyre ne territorin e këtij shteti, sipas paragrafit 1 te këtij neni. Transporti dhe shpenzimet ditore te këtyre punonjësve do te mbulohen nga autoriteti doganor kërkuar.

3. Kërkesa për paraqitje duhet të tregojë qarte se në çfare çështjeje dhe ne çfare kapaciteti do te paraqitet ky punonjës.

4. Punonjësi i autorizuar për tu paraqitur si dëshmitar apo ekspert ka privilegjin te refuzojë dhënien e evidencave apo deklaratave, nëse ka te drejtën apo është i detyruar te veproje kështu sipas legjislacionit kombëtar te Palës kontraktuese te kërkuar apo te Palës kontraktuese kërkuese.

5. Kërkesa për paraqitje e punonjësve si eksperte apo dëshmitare do te behet ne përputhje me legjislacionin ne fuqi ne territoret e shteteve te Palëve kontraktuese.

Neni 18

Perjashtime nga detyrimi per te dhene asistence

1. Nëse autoriteti doganor i kërkuar konsideron se përgjigja ndaj një asistence te kërkuar mund te bie ndesh me sovranitetin, sigurinë, ose interesa te tjera themelore te atij shteti, ose mund te përfshije shkelje te sekreteve profesionale, komerciale apo industriale, ose mund te jete ne kundërshtim me parimet baze te sistemit te tij ligjor, kjo Pale mund te refuzojë dhënien e asistencës se kërkuar sipas kësaj Marrëveshjeje tërësisht, ose mund ta japë atë pjesërisht, ose kushtëzuar nga disa kondita apo kërkesa te caktuara.

2. Nëse autoriteti doganor i ne Pale kontraktuese kerkon asistence, i cili vete nuk do te ishte ne gjendje t'ia jepte autoritetit doganor te Palës tjetër kontraktuese, ky fakt duhet përmendur ne kërkesë. Përgjigja ndaj nje kerkese te tille do te merret ne konsiderate varur nga legjislacioni ne fuqi ne territorin e shtetit te Palës kontraktuese te kërkuar.

3. Nëse asistenca refuzohet, vendimi dhe shkakut per refuzimin duhet ti njoftohet me shkrim autoritetit doganor kerkues pa vonese.

Neni 19

Shpenzimet

1. Autoritetet doganore te Palëve kontraktuese do te heqin dore nga çdo kërkesë për rimbursim te shpenzimeve te dala gjate zbatimit te kësaj Marrëveshjeje, me përjashtim te shpenzimeve

lidhur me ekspertet dhe dëshmitaret, dhe shpenzimet për përkthyesit dhe interpretuesit, kur këta nuk janë punonjës shteti. Nëse për ekzekutimin e kërkesës kerkohen ose mund të nevojiten shpenzime thelbësore dhe të një natyre të jahtezakonshme, autoritetet doganore do të bien dakort për të percaktuar kushtet dhe termat nën të cilat do të ekzekutohet kërkesa, si dhe për menyrën, me të cilat do të mbulohen shpenzimet.

Neni 20

Zbatimi

1. Zbatimi i kësaj Marrëveshjeje do të ngarkohet autoriteteve doganore të Palëve kontraktuese. Këto autoritete do të bien dakord reciprokisht mbi rregullimet e hollësishme për këtë qëllim.

2. Autoritetet doganore të Palëve kontraktuese mund të bien dakort që shërbimet e tyre të Antikontrabandes të jenë në komunikim direkt me njëri-tjetrin.

Neni 21

Zbatimi territorial

Marrëveshja do të zbatohet në territorin doganor të Republikës Shqiptare dhe në territorin doganor të Republikës së Sllovakisë.

Neni 22

Hyrja në fuqi dhe përfundimi

1. Kjo marrëveshjeje do të miratohet nga Palët kontraktuese në përputhje me legjislacionin e vet kombëtar dhe do të hyjë në fuqi gjashtëdhjetë ditë pasi Palët kontraktuese të njoftojnë njëra-tjetrën me një njoftim me shkrim nëpërmjet kanaleve diplomatike se të gjitha kërkesat ligjore kombëtare të nevojshme për hyrjen në fuqi të Marrëveshjes janë kompletuar.

2. Kjo Marrëveshjeje është konkluduar për një kohezgjatje të pakufizuar. Kjo Marrëveshjeje mund të përfundojë nëpërmjet një njoftimi me shkrim nga secila prej Palëve kontraktuese nëpërmjet kanaleve diplomatike dhe do të përfundojë se çëni në fuqi tre muaj pasi një njoftim i tillë është marrë nga Pala tjetër kontraktuese.

3. Procedimet në vazhdim në kohën e përfundimit do të kompletohen në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje.

4. Kjo Marrëveshjeje mund të amendohet mbi bazën e marrëveshjeve të ndërsjella të Palëve kontraktuese. Amendamentet duhen bërë me shkrim.

5. Sapo kjo Marrëveshjeje të hyjë në fuqi në marrëdhëniet ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Sllovakisë, Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës Popullore të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Socialiste të Çekosllovakisë mbi Bashkëpunimin dhe Asistencën e Ndërsjellë në çështjet Doganore, firmosur në Tiranë më 17 Tetor 1960, do të pushojë së ekzistuari.

Bërë në Tiranë më 16.12.2004 në dy kopje, në gjuhën shqipe, sllovaqe dhe angleze, ku të gjitha tekstet janë njelloj autentike. Në rast divergjence për shkak të interpretimit, do të mbizoterojë teksti në anglisht.

VENDIM
Nr.166, datë 25.3.2005

PËR DHËNIE SHITESË PENSIONI TË POSAÇËM SHTETËROR ZOTIT NDOC DODA
(GJETJA)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Dhënie shtesë pensioni të posaçëm shtetëror zotit Ndoc Doda (Gjetja), në masën e pensionit maksimal, por shuma e pensionit, që i takon sipas ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, plus këtë shtesë, të mos kalojë dyfishin e pensionit maksimal.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.172, datë 25.2.2005

PËR RISTRUKTURIMIN E KOMPANISË KOMANDO, TË FORCAVE TË ARMATOSURA
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, SË BASHKU ME STRUKTURAT MBËSHTETËSE, TË
DËRGUARA NË RAJONIN E GJIRIT PERSIK, NË KUADËR TË KOALICIONIT
NDËRKOMBËTAR TË LUFTËS KUNDËR TERRORIZMIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 3, të aktit normativ nr.1, datë 9.3.2003 të Këshillit të Ministrave, miratuar me ligjin nr.9025, datë 13.3.2003 “Për miratimin e aktit normativ nr.1, datë 9.3.2003, me fuqinë e ligjit “Për vënien në dispozicion të hapësirës tokësore, detare e ajrore dhe dërgimin e një force ushtarake shqiptare, në rajonin e Gjirit Persik, në kuadër të koalicionit ndërkombëtar të luftës kundër terrorizmit”, të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë”, dhe të neneve 7 e 10 të ligjit nr.9339, datë 21.12.2004 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2005”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI;

1. Ristrukturimin e kompanisë komando të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, së bashku me strukturat mbështetëse, të dërguara në rajonin e Gjirit Persik, në kuadër të koalicionit ndërkombëtar të luftës kundër terrorizmit.

2. Ministrisë së Mbrojtjes, në buxhetin e miratuar për vitin 2005, t’i shtohet fondi prej 163 000 000 (njëqind e gjashtëdhjetë e tre milionë) lekësh, për përbalimin e efekteve financiare të këtij vendimi.

3. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

4. Ngarkohen Ministri i Mbrojtjes dhe Ministri i Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.175, datë 25.3.2005

PËR SHLYERJEN E DETYRIMEVE TË PRAPAMBETURA TË UJËSJELLËSVE NDAJ KESH, SHA-SË, DHE TË TRETËVE, PËR TREMUJORIN E PARË TË VITIT 2005

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 10 të ligjit nr.9339, datë 21.12.2004 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2005”, me propozimin e Ministrit të Industrisë dhe të Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit t’i shtohet fondi prej 400 000 000 (katërqind milionë) lekësh, për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura të ndërmarrjeve të ujësjellësve, sipas listës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ndërmarrjet e ujësjellësve të shlyejnë detyrimet ndaj KESH, sha-së, në shumën prej 300 000 000 (treqind milionë) lekësh, dhe ndaj ARMO, sha-së, në shumën prej 100 000 000 (njëqind milionë) lekësh.

3. KESH, sh.a. të shlyejë detyrimet ndaj ARMO, sha-së, në shumën 300 000 000 (treqind milionë) lekë.

4. ARMO, sh.a. të shlyejë detyrimet ndaj Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, në shumën 270 000 000 (dyqind e shtatëdhjetë milionë) lekë ndaj Institutit të Sigurimeve Shoqërore, në shumën 30 000 000 (tridhjetë milionë) lekë, dhe ndaj Albpetrolit, në shumën 100 000 000 (njëqind milionë) lekë.

5. Albpetroli të shlyejë detyrimin ndaj Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, në shumën 100 000 000 (njëqind milionë) lekë.

6. Fondi prej 400 000 000 (katërqind milionë) lekësh, që do t’i shtohet Ministrisë së Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit, të përballohet nga fondi i kontingjencës, i vitit 2005.

7. Ngarkohen Ministria e Industrisë dhe e Energjetikës, Ministria e Financave dhe Ministria e Rregullimit të Territorit dhe e Turizmit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr. 184, datë 31.3.2005

PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2005, MIRATUAR PËR MINISTRINË E SHËNDETËSISË, PËR MBULIMIN E SHPENZIMEVE TË KURIMIT TË DR.ADRIAN OSMANLLIU JASHTË SHTETIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë”, dhe të nenit 7 të ligjit nr.9339, datë 21.12.2004 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2005”, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Shëndetësisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2005, zëri “Shpenzime operative”, t’i shtohet fondi prej 3 000 000 (tre milionë) lekësh për përballimin e shpenzimeve të kurimit të dr. Adrian Osmanlliu jashtë shtetit.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

3. Pagesa të bëhet pas paraqitjes së faturave për shpenzimet e kryera.
4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.187, datë 31.3.2005

PËR EMËRIM NË DETYRË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 6 të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Z. Adrian Petollari emërohet zëvendësministër i Ekonomisë.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.205, datë 7.4.2005

**PËR EMËRIM DHE LIRIM NGA DETYRA TË ANËTARIT TË KOMISIONIT KOMBËTAR
RREGULLATOR TË SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE LARGIMIT E
PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4 e 5 të ligjit nr.8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, me propozimin e Ministrit të Shtetit për Koordinimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Vilma Bibolli, anëtare e Komisionit Kombëtar Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura, lirohet nga kjo detyrë.
2. Arben Tase emërohet anëtar i Komisionit Kombëtar Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.219, datë 15.4.2005

**PËR MIRATIMIN E LIRIMIT NGA DETYRA TË INSPEKTORIT TË PËRGJITHSHËM TË
INSPEKTORATIT SHETËTOR TË PUNËS, Z.BLENDI MARIKA, DHE EMËRIMIT NË
KËTË DETYRË TË Z. SOKOL KRAJA**

Në mbnështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 8 të ligjit nr.7986, datë 13.9.1995 “Për Inspektoratin Shtetëror të Punës”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e lirimit të z. Blendi Marika nga detyra e inspektorit të përgjithshëm të Inspektoratit Shtetëror të Punës.
 2. Miratimin e emërimit të z. Sokol Kraja, drejtor i drejtorisë rajonale në Inspektoratin Shtetëror të Punës, inspektor i përgjithshëm i Inspektoratit Shtetëror të Punës.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.242, datë 21.4.2005

**PËR MIRATIMIN E DOKUMENTIT TË POLITIKAVE TË ZHVILLIMIT, PËR
PROGRAMIN E MENAXHIMIT TË INTEGRUAR DHE TË PASTRIMIT TË ZONËS
BREGDETARE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

- Miratimin e dokumentit të politikave të zhvillimit, për programin e menaxhimit të integruar dhe të pastrimit të zonës bregdetare, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

**LËNDA: DOKUMENTI I POLITIKAVE TË ZHVILLIMIT, PËR PROGRAMIN E
MENAXHIMIT TË INTEGRUAR DHE PASTRIMIT E ZONËS BREGDETARE**

1. Hyrje

Ky dokument është hartuar nga qeveria shqiptare në lidhje me Programin e Manaxhimit të Integruar dhe Pastrimit të Zonës Bregdetare (më poshtë: Programi) dhe ka për qëllim zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit në zonën bregdetare të vendit.

Programi është hartuar si një Program Huadhënës i Adaptueshëm i cili do të zbatohet gjatë një periudhe 7-vjecare, faza e I-rë e të cilit është planifikuar për periudhën shtator 2005 deri në gusht 2009 dhe faza e II-të për periudhën janar 2009 - gusht 2012. Faza e dytë do të ndërtohet mbi rezultatet fillestare të fazës së I-rë nëpërmjet mbështetjes së iniciativave të zhvillimit dhe investimeve të mëtejshme specifike.

Programi total pritet të kushtojë 66.5 milion USD.

Qeveria shqiptare është e angazhuar të punojë në bashkëpunim me donatorë bilateralë e multilateralë për realizimin e këtij programi dhe në muajin mars të këtij viti, kjo e fundit ftoi donatorët që operojnë në Shqipëri dhe jashtë saj për të siguruar një financim tjetër për këtë program.

2. Objektivi i programit.

Objektivi i Përgjithshëm i Programit, është të mbrojë burimet natyrore dhe pasuritë kulturore të bregdetit të Shqipërisë dhe të promovojë menaxhimin dhe zhvillimin e qëndrueshëm të tyre.

Objektivi i programit do të arrihet nëpërmjet:

1. Krijimit të kuadrit institucional dhe politik të menaxhimit të integruar të zonës bregdetare dhe forcimit të kapacitetit më të gjerë rregullator në nivelin qendror, rajonal dhe lokal për mbrojtjen e burimeve natyrore bregdetare dhe detare.

2. Rritjes së aksesit në shërbimet bazë e shoqëruar kjo me përmirësimin e cilësisë së jetës dhe tërheqjes ndaj zonave bregdetare.

3. Zbatimin e nënprojekteve që kanë si synim promovimin e zhvillimit të qëndrueshëm të sektorit të turizmit.

3. Fazat e programit

Programi do të jetë i ndarë në fazat e mëposhtme:

Faza I. Faza e I-rë e programit synon formulimin dhe zbatimin e politikave që mbështesin menaxhimin e integruar të zonës bregdetare për reduktimin e degradimit bregdetar. Faza e I-rë, do të jetë përmirësimi i kuadrit ligjor, politikave rregullatore dhe qeverisjes së zonës bregdetare, promovimi i planifikimit të integruar të zonës bregdetare; nxitja e mbështetjes së komunitetit për menaxhimin e qëndrueshëm të zonës bregdetare dhe realizimi i investimeve të infrastrukturës bazë që promovon zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit në vend.

Kjo fazë do të kontribuojë në zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm, në përmirësimin e kushteve mjedisore, përmirësimin e cilësisë së jetës, ruajtjen dhe rrijetëzimin e trashëgimisë kulturore dhe arkitekturore të komuniteteve bregdetare jugore të synuara.

Gjithashtu kjo fazë do të synojë reduktimin e rreziqeve për shëndetin e njerëzve në komunitetet përreth zonës së nxehtë industriale të Porto Romanos.

Faza e II. Faza e II-të e programit do të zhvillojë më tej kapacitetin institucional, ligjor dhe rregullator të menaxhimit të integruar dhe do të mbështesë zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit në mënyrë që ai të shërbejë si një mjet i rritjes ekonomike.

Duke u mbështetur në arritjet dhe realizimet e fazës së I-rë dhe mbi mësimet e nxjerra nga ajo, faza e II-të e programit do të shtrijë në mënyrë të konsiderueshme mbështetjen e tij për infrastrukturën bregdetare, menaxhimin e zonave të mbrojtura, ruajtjen/rehabilitimin e ekosistemeve kritike detare dhe bregdetare, pastrimin dhe rehabilitimin e zonave të ndotura, si dhe zgjerimin e zhvillimit të qëndrueshëm të turizmit komunitar.

Në të njëjtën kohë kjo fazë do të promovojë edhe partneritetet publike-private. Fusha të veçanta mbështetjeje në kuadrin e fazës së II-të do të përcaktohen gjatë fazës së I-rë.

Faza e II-të do të ndërthuret me projektin e financuar nga GEF (Global Environment Facility) në kuadrin e Fondit të Investimit të Partneritetit të Detrave Mesdhe/Adriatik.

4. Objektivat e zhvillimit të programit, faza e I-rë.

Objektivi i zhvillimit të programit gjatë fazës së I-rë është të krijojë dhe fillojë ndjekjen e një metode menaxhimi të integruar të zonës bregdetare për të reduktuar degradimin e kësaj zone nëpërmjet:

1. Forcimit të politikave rregullatore dhe qeverisjes së zonës bregdetare, përdorimit të tokës dhe kapacitetit planifikues dhe institucional në nivel qendror, rajonal dhe lokal;

2. Fillimit të investimeve të fokusuara, bashkiake dhe komunitare në bregdetin jugor, për të përmirësuar kushtet mjedisore, burimet kulturore dhe për të inkurajuar mbështetjen e komunitetit për menaxhimin e qëndrueshëm të zonës bregdetare;

3. Reduktimit të ndotjes së dheut dhe ujërave nëntokësore në ish/uzinën kimike të Porto Romanos.

5. Politikat e zhvillimit.

Qeveria shqiptare është e angazhuar të zbatojë principet kryesore të Menaxhimit të Integruar të Zonës Bregdetare:

1. Balancimin e përfitimeve të zhvillimit ekonomik, ruajtjes, mbrojtjes dhe rijetëzimit të zonës bregdetare si dhe

2. Balancimin ndërmjet aksesit publik e privat dhe shfrytëzimit të zonës bregdetare.

Gjithashtu qeveria ka marrë përsipër të ngrijë përkohësisht aprovimin e studimeve pjesore dhe dhënien e lejeve të ndërtimit në zonat turistike të bregdetit të jugut, deri në hartimin dhe miratimin e studimit të zhvillimit të bregdetit të jugut nga ana e Këshillit të Rregullimit të Territorit të Republikës (KRRTRSH). Studimet lokale do të përgatiten në përputhje me parametrat e vendosura në studim.

Qeveria do të ndjekë një metodë pjesëmarrjeje në zbatimin e programit, duke përfshirë grupet e interesuara dhe komunitetin e gjerë në nivel qendror, rajonal, bashkiak dhe komune.

6. Treguesit e ecuresisë për fazën e I-rë

Treguesit kyç për arritjen e objektivave të fazës së I-rë do të jenë si më poshtë:

- Të ketë përfunduar procesi i hartimit dhe aprovimit të studimit, nga Këshilli i Rregullimit të Territorit të Republikës së Shqipërisë (KRRTRSH).

- Zhvillimi i infrastrukturës publike në zonën bregdetare jugore të jetë në përputhje me studimin.

- Planifikimi i përdorimit të tokës dhe dhënia e lejeve të ndërtimit, të jenë në përputhje me parametrat dhe masat e caktuara në studim.

- Ndërtesat e reja në zonën bregdetare jugore, të mos shqetësojnë vlerat dhe karakteristikat hapësinore ekzistuese.

- Planifikimi fizik lokal, rajonal dhe kombëtar dhe investimet, të jenë në përputhje me parimet dhe udhëzimet e studimit.

- Pjesëmarrja e grupeve të interesuara, të integrohet në vendimmarrjen mbi menaxhimin e zonës bregdetare.

- Të paktën 5 000 ton mbetje familjare dhe 5 000 ton mbetje ndërtimesh dhe shkatërrimesh, të mbledhen dhe eliminohen në mjedise të përcaktuara dhe të përshtatshme.

- Të paktën 50 % e plazheve publike dhe e zonave të molusqeve përgjatë bregdetit, do t'i monitorohet cilësia e ujit në përputhje me standardet shqiptare dhe direktivat e BE-së.

- Të ketë një rritje të dukshme në shpenzimet e turistëve dhe vizitorëve në bregdetin jugor, gjë që sjell përfitim për komunitete më të gjera.

- Plani i menaxhimit të zonave të mbrojtura për Parkun Kornbëtar të Butrintit, të zhvillohet me pjesëmarrje të gjerë të aktorëve të interesuar dhe rregullat të zbatohen nëpërmjet akteve të duhura nënligjore.

- Përcaktimi i zonave dhe planet e përdorimit të tokës të jenë hartuar dhe përcaktuar për të paktën 3 bashki dhe/ose komuna bregdetare.

- Vlerësimi i ndikimit mbi mjedisin (VNM), të kryhet në përputhje me procedurat e VNM ve dhe me legjislacionin shqiptar, përpara dhënies së lejeve mjedisore dhe fillimit të ndërtimeve dhe aktiviteteve të zhvillimit në zonën bregdetare jugore.

- Planet e zhvillimit vendor të jenë formuluar dhe aprovuar për të paktën 5 komuna që ndodhen në bregdetin e jugut.

- Të jetë arritur reduktimi i ndotjes së dheut në zonat pranë qendrave të populluara në Porto Romano.

7. Kushtet për futjen në fazën e II-të

Kushtet e ecuresisë që duhet të plotësohen për të kaluar në fazën e II-të janë:

- Të jetë hartuar, zbatuar e forcuar kuadri ligjor e institucional rregullator për Menaxhimin e Integruar të Zonës Bregdetare në nivel lokal, rajonal e kombëtar.

- Të hartohen plane rajonale dhe lokale të zhvillimit të përdorimit të tokës në zonën bregdetare, në përputhje me kriteret dhe metodologjitë e aprovuara të planifikimit të përdorimit të tokës, që të përfshijnë vlerësimin strategjik mjedisor në procesin e planifikimit, duke zbatuar një

mënyrë planifikimi me pjesëmarrje.

- Të bëhet vlerësimi strategjik mjedisor dhe kuadri i shpërnguljes, për të udhëhequr investimet në bregdetin e jugut.

- Të jenë përmirësuar kapacitetet institucionale për zbatimin dhe monitorimin e planeve të përdorimit të tokës, rregulloreve të ndërtimit dhe të vlerësimit të ndikimit mjedisor në zonën e jugut. Rezultatet e monitorimit dhe inspektimit të zbatimit të tyre ligjor të vihen në dispozicion të publikut.

- Ministria e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit të tregojë një rritje të përfshirjes së saj në çështje dhe shqetësime mjedisore.

- Veprimtaritë e pastrimit dhe investimeve në infrastrukturën mjedisore të fazës së I-rë, të tregojnë përparim të kënaqshëm (të paktën 70% angazhim dhe 50% disbursim i komponentit B - Infrastruktura dhe Rehabilitimi Mjedisor Bregdetar).

- Të hartohet dhe miratohet nga këshilli bashkiak i Durrësit, plani i përdorimit të tokës për Porto Romanon.

8. Kuadri i trajtimit të çështjeve mjedisore dhe sociale

Qeveria shqiptare është e angazhuar të miratojë dhe aderojë në një paketë procedurash që janë të nevojshme për të integruar sistematikisht çështjet mjedisore dhe sociale, në procesin e zbatimit të programit.

Procedurat duhet të përfshijnë:

1. Adoptimin e Kuadrit të Mbrojtjes Mjedisore dhe Sociale (Environmental and Social Safeguards Framework - ESSF) për të trajtuar çështjet e mjedisit, shitblerjes së tokës, kufizimit të aksesit, si dhe ato të pronësisë kulturore që lidhen me investimet infrastrukturore dhe planin e menaxhimit të zonave të mbrojtura për Parkun e Butrintit, si dhe për investimet e ardhshme që do të ndërmerren në zbatim të studimit në të gjithë zonën bregdetare jugore.

Për sa më sipër, plotësohen kërkesat e legjislacionit shqiptar dhe Politikat e Mbrojtjes Mjedisore dhe Sociale të Bankës Botërore, duke përfshirë kërkesat që lidhen me vlerësimin mjedisor, shpërnguljen e detyruar dhe pronësinë kulturore.

2. Të kryhet Vlerësimi Strategjik Mjedisor (VSM) për studimin gjatë procesit të hartimit të tij në përputhje me rregullat mjedisore shqiptare dhe politikave të Bankës Botërore.

3. Të bëhet adoptimi i procedurave dhe masave të duhura, përfshirë një kuadër politik të shpërnguljes për të gjithë zonën bregdetare jugore, për të shmangur (dhe aty ku nuk është e mundur të shmangen, për të zbutur) rreziqet ndaj individëve dhe komuniteteve në qoftë se studimi dhe përcaktimi i zonave, rregulloret dhe investimet specifike, do të kenë efekte negative në lidhje me humbjen e tokës apo jetesës. Këto procedura do të plotësojnë kërkesat e politikës së Bankës Botërore mbi shpërnguljen e detyruar.

Në qoftë se do të ketë nevojë që politika e shpërnguljeve të zbatohet për zonat e mbuluara nga studimi, atëherë do të hartohet një plan shpërnguljeje. Në përgjithësi, parimi i kësaj politike është të ndihmojë personat e prekur në përpjekjet e tyre për të përmirësuar dhe risjellë standardin e jetesës së tyre në nivelin që ishte përpara fillimit të zbatimit të programit apo nivelin përpara shpërnguljes.

4. Të bëhet kryerja e vlerësimeve të ndikimit mbi mjedisin (EIAs) më specifik investimet, të cilat plotësojnë kërkesat e legjislacionit shqiptar dhe politikat operative të Bankës Botërore, për çdo investim individual të zbatueshëm në kuadrin e programit.

9. Masat institucionale dhe zbatuese

1. Komiteti Drejtues i Programit (PSC). Qeveria do të krijojë Komitetin Drejtues të Programit, që do të jetë përgjegjes për mbikëqyrjen e përgjithshme të projektit, vlerësimi i progresit dhe asistencë në kapërcimin e vështirësive për zbatimin e tij.

Komiteti do të përfshijë vendimmarrës të nivelit të lartë (në nivel zëvendësministri) nga Ministria e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit (kryesia), Ministria e Financave, Ministria e Ekonomisë, Ministria e Mjedisit, Ministria e Transporteve dhe Telekomunikacionit dhe Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Ministria e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit, Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit, si dhe përfaqësues nga administratat rajonale dhe lokale dhe OJF-të.

2. Njësia e Koordinimit të Programit - Program Coordination Unit (PCU). Koordinimi i përgjithshëm institucional i programit do të bëhet nga Ministria e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit, si agjencia drejtuese qeveritare e ngarkuar me koordinimin e përgjithshëm të programit.

Do të krijohet një Njësi e Koordinimit të Programit (PCU) brenda strukturës së MRRTT për të marrë përgjegjësinë e koordinimit të projektit, prokurimin, menaxhimin financiar, disbursimet, monitorimin, vlerësimin dhe raportimin, dhe do të jetë në varësinë e zyrtarit autorizues të programit.

3. Zyrtari autorizues i programit - Program Authorizing Official (PAO). PAO do të jetë Zv/Ministri i Ministrisë së Rregullimit të Territorit dhe Turizmit, i cili do të ketë përgjegjësinë e mbikëqyrjes së punës së PCU dhe nënshkrimin të veprimtarive të prokurimit. PAO do t'i raportojë qeverisë, nëpërmjet Komitetit Drejtues të Programit, mbi përparimin e zbatimit të tij.

Veprimtaritë e programit do të zbatohen nga entet ekzistuese në nivel qendror, rajonal dhe lokal.

4. Ministria e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit. MRRTT, nëpërmjet PCU do të jetë përgjegjëse për mbikëqyrjen dhe mbështetjen e aktiviteteve të kryera nga MRRTT. Në funksion të zbatimit të programit, MRRTT mund të formojë një ekip në rang rajonal për aktivitete të ndryshme të programit.

5. Ministria e Mjedisit do të jetë përgjegjëse për zbatimin e punës rehabilituese të Porto Romanos dhe veprimtaritë e forcimit institucional që lidhen me të.

Do të krijohet një ekip zbatues (MoE - IT) për mbikëqyrjen dhe mbështetjen e të gjitha aspekteve teknike të zbatimit të veprimtarive të projektit që janë nën përgjegjësinë e Ministrisë së Mjedisit.

6. Ministria e Transporteve dhe Telekomunikacionit. Autoriteti i portit të Sarandës do të emërojë një koordinator programi që të jetë përgjegjës për aspektet teknike dhe lehtësimin e zbatimit të veprimtarive që lidhen me punët rehabilituese të portit të Sarandës

Drejtoria e Përgjithshme e Lundrimit Detar në këtë ministri do të jetë përgjegjëse për mbikëqyrjen e këtij procesi.

7. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve. Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sporteve, nëpërmjet administratës së Parkut Kombëtar të Butrintit, do të jetë përgjegjëse për zbatimin e veprimtarive të menaxhimit të zonave të mbrojtura dhe për lehtësimin e zbatimit të veprimtarive në kuadrin e pjesës së mbrojtjes mjedisore dhe veprimtarive të qëndrueshme ekonomike.

8. Bashkitë dhe komunat bregdetare. Autoritetet vendore të zonës bregdetare të jugut do të jenë përgjegjëse për lehtësimin e planifikimit dhe zbatimit të veprimtarive të menaxhimit të mbetjeve të ngurta. Komunat dhe bashkitë e zonave bregdetare do të jenë përgjegjëse për planifikimin e implementimin e aktiviteteve të përfshira në projektin e ruajtjes dhe zhvillimit të fshatit bregdetar.

10. Monitorimi dhe vlerësimi.

Funksioni i monitorimit dhe vlerësimit të programit do të kryhet nga PCU në MRRTT.

PCU do të jetë përgjegjëse për përgatitjen e raporteve menaxhuese tremujore dhe 1-vjeçare, të cilat do t'i dorëzohen Komitetit Drejtues të Projektit, Bankës Botërore dhe bashkëfinancuesve të programit. Vlerësimi i veprimtarive të forcimit institucional, do të bëhet nga konsulentë të pavarur për vlerësimin e rezultateve të programit në lidhje me forcimin e kapaciteteve lokale, në mes të periudhës dhe nga fundi i programit.

Gjithashtu, me përfituesit nga fshatrat e përfshirë në programin e infrastrukturës dhe rehabilitimit mjedisor të bregdetit do të bëhen sondazhe në fillim, në mes dhe në fund të projektit për të vlerësuar ndikimin e programit.

VENDIM
Nr.295, datë 6.5.2005

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2005, MIRATUAR PËR MINISTRINË
E SHËNDETËSISË, PËR MBULIMIN E PJESSHËM TË SHPENZIMEVE TË KURIMIT TË
ZNJ.XHEMILE KUKA, NË TURQI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë”, dhe të nenit 10 të ligjit nr.9339, datë 21.12.2004 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2005”, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Shëndetësisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2005, zëri “Shpenzime operative”, t’i shtohet fondi prej 1 000 000 (një milion) lekësh, për përballimin e pjesshëm të shpenzimeve të kurimit të znj. Xhemile Kuka, në Turqi.
2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.
3. Pagesa të bëhet pas paraqitjes së faturave përkatëse.
4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr. 347, datë 20.5.2005

PËR LIRIM DHE EMËRIM NË DETYRË TË PREFEKTIT TË QARKUT SHKODËR

Në mbështetje të nenit 114 të Kushtetutës dhe të nenit 4 të ligjit nr.8927, datë 25.7.2002 “Për prefektin” me propozimin e Ministrit të Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Z. Ramadan Hasanaj, prefekt i qarkut Shkodër, të lirohet nga kjo detyrë, sipas kërkesës së vet, si rrjedhojë e kandidimit për deputet në zgjedhjet parlamentare të vitit 2005.
 2. Z. Oltion Luli të emërohet prefekt i qarkut Shkodër.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr. 349, datë 20.5.2005

PËR LIRIM DHE EMËRIM NË DETYRË TË PREFEKTIT TË QARKUT ELBASAN

Në mbështetje të nenit 114 të Kushtetutës dhe të nenit 4 të ligjit nr.8927, datë 25.7.2002 “Për prefektin”, me propozimin e Ministrit të Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Z. Qazim Sejdini, prefekt i qarkut Elbasan, të lirohet nga kjo detyrë, sipas kërkesës së vet, si rrjedhojë e kandidimit për deputet në zgjedhjet parlamentare të vitit 2005.
2. Z. Agim Leka të emërohet prefekt i qarkut Elbasan.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.350, datë 20.5.2005

PËR LIRIM DHE EMËRIM NË DETYRË TË PREFEKTIT TË QARKUT FIER

Në mbështetje të nenit 114 të Kushtetutës dhe të nenit 4 të ligjit nr.8927, datë 25.7.2002 “Për prefektin”, me propozimin e Ministrit të Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Znj. Rajmonda Stefa, prefekt i qarkut Fier, të lirohet nga kjo detyrë, sipas kërkesës së vet, si rrjedhojë e kandidimit për deputet në zgjedhjet parlamentare të vitit 2005.
2. Z. Vladimir Malo të emërohet prefekt i qarkut Fier.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.360, datë 26.5.2005

PËR LIRIM DHE EMËRIM NË DETYRË TË PREFEKTIT TË QARKUT TË GJIROKASTRËS

Në mbështetje të nenit 114 të Kushtetutës dhe të nenit 4 të ligjit nr.8927, datë 25.7.2002 “Për prefektin” me propozimin e Ministrit të Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Z. Anesti Deçka, prefekt i qarkut të Gjirokastrës, të lirohet nga kjo detyrë, sipas kërkesës së vet, si rrjedhojë e kandidimit për deputet në zgjedhjet parlamentare të vitit 2005.

2. Z. Murat Kaçi të emërohet prefekt i qarkut të Gjirokastrës.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.361, datë 26.5.2005

PËR LIRIM DHE EMËRIM NË DETYRË TË PREFEKTIT TË QARKUT TË LEZHËS

Në mbështetje të nenit 114 të Kushtetutës dhe të nenit 4 të ligjit nr.8927, datë 25.7.2002 “Për prefektin” me propozimin e Ministrit të Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Z. Gjergji Rakaj, prefekt i qarkut të Lezhës, të lirohet nga kjo detyrë, sipas kërkesës së vet, si rrjedhojë e kandidimit për deputet në zgjedhjet parlamentare të vitit 2005.
2. Z. Agustin Marku të emërohet prefekt i qarkut të Lezhës.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.366, datë 30.5.2005

PËR LIRIM DHE EMËRIM NË DETYRË

Në mbështetje të nenit 114 të Kushtetutës dhe të nenit 4 të ligjit nr.8927, datë 25.7.2002 “Për prefektin” me propozimin e Ministrit të Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Znj. Mimi Kodheli, prefekt i qarkut të Tiranës, të lirohet nga kjo detyrë, sipas kërkesës së vet, si rrjedhojë e kandidimit për deputet në zgjedhjet parlamentare të vitit 2005.
2. Znj. Edlira Haxhiymeri të emërohet prefekt i qarkut të Tiranës.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr. 367, datë 30.5.2005

PËR LIRIM NGA DETYRA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 6 të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Znj. Edlira Haxhiymeri, zëvendësministër i Arsimit dhe i Shkencës lirohet nga kjo detyrë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.416, datë 9.6.2005

**PËR DHËNIE MUNICIONI FORCAVE TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË
TURQISË, NË KUADËR TË BASHKËPUNIMIT DYPALËSH NË FUSHËN E MBROJTJES**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 7 të nenit 14 të ligjit nr.8671, datë 26.10.2000 “Për pushtetet dhe autoritetin e komandimit e të drejtimit strategjik të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Municionet e hequra nga armatimi, në sasinë 1 200 000 fishekë, të modelit 7.62 x 39 mm (model 56), sipas vendimit nr.617, datë 4.12.2002 të Këshillit të Ministrave “Për heqjen nga armatimi dhe përdorimi të një pjese të armëve, teknikës dhe pajisjes së Forcave të Armatosura dhe për asgjësimin ose çmontimin dhe shitjen e tyre”, t’u jepen falas Forcave të Armatosura të Republikës së Turqisë, në kuadër të bashkëpunimit dypalësh në fushën e mbrojtjes.

2. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.436, datë 16.6.2005

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2005, MIRATUAR PËR MINISTRINË
E SHËNDETËSISË, PËR MBULIMIN E PJESSHËM TË SHPENZIMEVE TË KURIMIT TË
Z.GENTIAN SHKOZA JASHTË SHTETIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë”, dhe të nenit 7 të ligjit nr.9339, datë 21.12.2004 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2005”, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Shëndetësisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2005, zëri “Shpenzime operative”, t’i shtohet fondi prej 1 000 000 (një milion) lekësh, për mbulimin e pjesëm të shpenzimeve të kurimit të z.Gentian Shkoza jashtë shtetit.
2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.
3. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.438, datë 16.6.2005

PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI TË KOMUNËS LABINOT-FUSHË TË MJEDISEVE TË PRONËS “GRUP DEPO TË REPARTIT USHTARAK NR.8833”, NË MENGEL, ELBASAN, NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË MINISTRISË SË MBROJTJES, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.515, DATË 18.7.2003 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Mjediset e pronës “Grup depo të repartit ushtarak nr.8833, në Mengel të qarkut të Elbasanit, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes, të kalojnë në pronësi të komunës Labinot-Fushë të qarkut të Elbasanit, për sistemimin e familjeve të prekura nga fatkeqësia natyrore në komunat Godolesh, Griqan dhe Xibrakë.
2. Prona me numër rendor 316 “Grup depo të repartit ushtarak nr.8833” në Mengel të qarkut Elbasan, të hiqet nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, e cila i bashkëlidhet vendimit nr.515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave.
3. Komunës Labinot-Fushë i ndalohet ta ndryshojë destinacionin e pronës së përcaktuar në këtë vendim.
4. Ngarkohen Ministri i Mbrojtjes, Ministri i Pushtetit Vendor dhe i Decentralizimit, kryerregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Labinot-Fushë të ndjekin procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Gjergj Fishta", mbrapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 24 27 003.

Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2010 është 16 000 lekë.

Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI PENAL	226 lekë
KODI I PROCEDURËS PENALE.....	330 lekë
KUSHTETUTA	95 lekë
PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë

Hyri në shtyp më 4.6.2010

Doli nga shtypi më 6.6.2010

Tirazhi: 2300 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2010

Çmimi 36 lekë